

# Nënkryetari i komunës për komunitete

2020

Nënkryetari i komunës për komunitete (NKKK) është mekanizëm mbrojtës në nivel lokal që është i detyrueshëm në komunat ku komunitetet përbëjnë të paktën dhjetë për qind të popullsisë së komunës. Me vendim të kuvendit të komunës, mund të krijohet edhe në komuna ku popullsia nga radhët e komuniteteve në pakicë numerike nuk e arrin pragun prej dhjetë për qind. Kandidatin për NKKK e propozon kryetari i komunës dhe e miraton kuvendi i komunës. NKK është i mandatuar për të dhënë këshilla dhe udhëzime për kryetarin e komunës për çështjet që lidhen me komunitetet dhe duhet të përfaqësojë të gjitha komunitetet që banojnë në komunë.

## Dokumentet kryesore

- Ligji për vetëqeverisjen lokale (nr. 03/L-040, 2008);
- Udhëzimi administrativ (MAPL) nr. 01/2014 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna;\*
- Termat e referencës për NKKK

\* Udhëzimi administrativ (MAPL) nr. 01/2014 u shfuqizua me hyrjen në fuqi të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna më 21 shtator 2020.

## Themelimi

NKKK-të janë themeluar në 14 komuna.


### Pozitat e themeluara të NKKK-ve\*

Dragash	Mamushë
Ferizaj	Novobërdë
Fushë Kosovë	Obiliq
Gjilan	Prizren
Kamenicë	Shtërpcë
Klllokot	Zubin Potok <sup>1</sup>
Lipjan	Zveçan <sup>1</sup>

<sup>1</sup> Mungesa e të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullsisë për këto komuna krijon paqartësi në lidhje me themelimin e kësaj pozite. Prandaj, për qëllime të kësaj analize janë përdorur vlerësimet e numrit të popullsisë në Profilet e komunave të Kosovës të përpiluara nga Misioni i OSBE-së në vitin 2018. (Gjenden tek <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>)

\* Me shkronja të zeza të theksuara janë të paraqitura komunat ku NKKK-të janë të detyrueshëm sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullsisë. Në Graçanicë, pozitë ishte boshe gjatë periudhës së raportimit, megjithëse është i detyrueshëm. Prandaj, pozita nuk pasqyrohet në diagrame dhe tabelën e performancës


## Qasja në burime financiare\*



\* Siç është vlerësuar nga NKKK-të.


## Përbërja gjinore dhe përfaqësimi i komuniteteve

### NKKK sipas përkatësisë në komunitet



- Shqiptar i Kosovës
- Serb i Kosovës
- Boshnjak i Kosovës
- Ashkali i Kosovës
- Turk i Kosovës

### NKKK-të sipas gjinisë



- Gra
- Burra

\* Tri komunat me NKKK gra janë Klllokoti, Mamusha dhe Prizreni.


# Performanca në vitin 2020

## Treguesit e zgjedhur të performancës


Numri i NKKK-ve që ndërmorën aktivitetet kryesore dhe detyrat themelore të përshkruara në kornizën ligjore dhe të politikave, bazuar në monitorimin e rregullt të ekipeve në terren të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe shqyrtimet specifike periodike nga ekipet në terren, si dhe raportet e përgatitura komunat.

### 1 - Këshillat, udhëzimet dhe mbikëqyrja

Ofrimi i këshillave dhe udhëzimeve për kryetarin për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet




Konsultimi me kryetarin e komunës për çështje që kanë të bëjnë me nevojat dhe interesat e komuniteteve gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit




### 2 – Buxheti

Sigurimi që mekanizmeve komunalë u janë ndarë mjete të mjaftueshme në interes të drejtave të komuniteteve




### 3 – Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve

Angazhimi në aktivitete që promovojnë dialogun ndërmjet komuniteteve




### 4 – Bashkëpunimi

Veprimi si pikë kontakti për zbatimin e rekomandimeve të KK-së nga ana e kuvendit të komunës




Promovimi i përfshirjes së drejtpërdrejtë të komuniteteve në aktivitetet e kuvendit të komunës



### 5 - Raportimi

Raportimi tek kryetari çdo gjashtë muaj



■ Po ■ Jo

## Performanca e gjithmbarshme

Vlerësimi i performancës së NKKK-ve bazohet në rezultatin total të përbushjes së treguesve të performancës, që janë pasqyrim i aktiviteteve kryesore dhe detyrave themelore të parapara në kornizën përkatëse ligjore dhe të politikave. Performanca është vlerësuar si e "E lartë", kur rezultati total është mbi 66 për qind, "Mesatare" kur varion mes 66 për qind dhe 33 për qind, dhe "E ulët", kur është nën 33 për qind.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ofron mbështetje për pjesëmarrjen e shtuar të komuniteteve në proceset e vendimmarrjes e qeverisjes si dhe në institucione. Në suazat e këtyre përpjekjeve, Misioni i OSBE-së në Kosovë e monitoron rregullisht punën e mekanizmeve komunalë për mbrojtjen e komuniteteve. Këto fletushka informuese kanë si qëllim t'u ofrojnë institucioneve përkatëse tregues që mund t'u ndihmojnë në identifikimin e mangësive dhe përmirësimin e pajtueshmërisë.

	Këshillat, udhëzimet dhe mbikëqyrja	Buxheti	Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve	Bashkëpunimi	Raportimi	Performanca e gjithmbarshme
Dragash	E lartë	E lartë	E ulët	Mesatare	E lartë	65%
Fushë Kosovë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	97%
Kllokot	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E ulët	81%
Novobërdë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	100%
Prizren	E lartë	E lartë	E lartë	Mesatare	E ulët	71%
Shtërpcë	E lartë	E ulët	E lartë	Mesatare	E lartë	73%
Ferizaj	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	97%
Gjilan	E lartë	E ulët	E ulët	E ulët	E lartë	46%
Kamenicë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	92%
Lipjan	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	97%
Mamushë	E lartë	E ulët	E ulët	Mesatare	E ulët	28%
Obiliq	E lartë	E lartë	E lartë	Mesatare	E ulët	65%
Zubin Potok	E lartë	E ulët	E ulët	E ulët	E lartë	40%
Zveçan	E lartë	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët	26%